



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 01/88

Datë: 20.05.2016

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011, dhe të nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 20 maj 2016, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet me ndryshime Projektligji për Mbrojtjen e Fëmijës.
2. Obligohet Zyra e Kryeministrit për përfshirjen e ndryshimeve në tekstin e Projektligjit nga pika 1. e këtij vendimi.
3. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që Projektligjin nga pika 1. e këtij vendimi t'ia procedojë për shqyrtim dhe miratim Kuvendit të Republikës së Kosovës.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAJA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 02/88

Datë: 20.05.2016

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, të nenit 6 paragrafi 6.2 pika (h) të plotësim ndryshimit të Ligjit Nr. 04/L-194, dhe të nenit 8 të Ligjit nr. 03/L-128 për Auditimin e Brendshëm, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011, dhe të nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 20 maj 2016, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet Raporti Vjetor për Funkcionimin e Sistemit të Kontrollit Brendshëm të Financave Publike në Sektorin Publik të Kosovës për vitin 2015.
2. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që Raportin nga pika 1. e këtij vendimi t'ia procedojë Kuvendit të Republikës së Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Isa MUSTAFA**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

Nr. 03/88

Datë: 20.05.2016

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 13 të Ligjit Nr. 04/L-131 për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011, dhe të nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 20 maj 2016, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Pensioni kontributpagues i moshës është 140 (njëqindekatërdhjetë) euro.
2. Vlera e pensioneve kontributpaguese të moshës sipas përgatitjes shkollore është:
  - 2.1. Pensioni për pensionistët me përgatitje shkollore të ulët, është 158 euro;
  - 2.2. Pensioni për pensionistët me përgatitje shkollore të mesme, është 172 euro;
  - 2.3. Pensioni për pensionistët me përgatitje shkollore të lartë, është 186 euro;
  - 2.4. Pensioni për pensionistët me përgatitje shkollore superiore, është 230 euro.
3. Të gjithë pensionistët kontributpagues të moshës të cilët kanë parashtruar kërkesën deri me datën 31 mars 2016 dhe bazuar në verifikimin për kategorizimin e pensionit sipas përgatitjes shkollore, do të paguhet për periudhën retroaktive nga data 1 janar 2016.
4. Të gjithë pensionistët kontributpagues të moshës të cilët kanë parashtruar kërkesën pas datës 31 mars 2016 dhe bazuar në verifikimin për kategorizimin e pensionit sipas përgatitjes shkollore, do të paguhet nga data përkatësisht muaji i parashtrimit të kërkesës.
5. Obligohet Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.
6. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Isa MUSTAFA**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 04/88

Datë: 20.05.2016


Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 29 të Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011, dhe të nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 20 maj 2016, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet kërkesa e Ministrisë së Shëndetësisë për kompensimin e shtesave për punëtorët e Klinikës së Kardiokirurgjisë dhe Kardiologjisë Invazive për vitin 2016, në shumë prej 82,200 euro. Mjetet ndahen në Shërbimin Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës (me kod 220) në nën-programin Shërbimet Terциare Shëndetësore - QKUK ( me kod 70100) si në vijim:
  - 1.1. 15,600 euro për 2 kardiokirurgë nga 650 euro shtesë në muaj për 12 muaj të vitit 2016, kategoria ekonomike e pagave dhe mëditjeve;
  - 1.2. 16,200 euro për 3 anesteziologë nga 450 euro shtesë në muaj për 12 muaj të vitit 2016, kategoria ekonomike e pagave dhe mëditjeve;
  - 1.3. 12,600 euro për 7 kardiologë invaziv nga 450 euro shtesë në muaj për 4 muaj të vitit 2016, kategoria ekonomike e pagave dhe mëditjeve;
  - 1.4. 3,600 euro për 2 perfuzionistë nga 150 euro shtesë në muaj për 12 muaj të vitit 2016, kategoria ekonomike e pagave dhe mëditjeve;
  - 1.5. 7,200 euro për 4 instrumentalë nga 150 euro shtesë në muaj për 12 muaj të vitit 2016, kategoria ekonomike e pagave dhe mëditjeve;
  - 1.6. 3,000 euro për 5 teknikë të sallave në kardiologji invazive nga 150 euro shtesë në muaj për 4 muaj të vitit 2016, kategoria ekonomike e pagave dhe mëditjeve;
  - 1.7. 24,000 euro për 20 infermierë të repartit nga 100 euro shtesë për 12 muaj të vitit 2016, kategoria ekonomike e pagave dhe mëditjeve.
2. Mjetet nga pika 1. e këtij vendimi ndahen nga Shpenzimet e Paparashikuara, nën programi Shpenzimet e Paparashikuara me kod 13100, kategoria ekonomike e Rezervës.
3. Obligohet Ministria e Shëndetësisë përkatësisht nën-programi Stimulimi i performancës për kuadro profesionale (me kod 78800) që nga kategoria ekonomike mallrat dhe shërbimet të transferojë mjetet në shumë prej 82,200 euro në Shpenzimet e Paparashikuara, nën programi Shpenzimet e Paparashikuara me kod 13100, kategoria ekonomike e Rezervës. Ky transfer duhet të bëhet gjatë procesit të Rishikimit të Buxhetit për vitin 2016.

4. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës, Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Financave.
5. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

**Isa MUSTAFA**

  
Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

Nr. 05/88

Datë: 20.05.2016

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 29 të Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011, dhe të nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 20 maj 2016, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet kërkesa e Prokurorisë së Shtetit për ndarjen e mjeteve financiare në shumë prej 207,259 euro, për mbulimin e shpenzimeve të qirasë për objektin e Prokurorisë Themelore në Mitrovicë, si dhe për mbulimin e shpenzimeve për inventar dhe pajisje të teknologjisë informative. Ndarja e këtyre mjeteve bëhet me qëllim të zbatimit të Ligjit nr. 04/L-199 për Ratifikimin e Marrëveshjes së Parë Ndërkombëtare të Parimeve që Rregullojnë Normalizimin e Marrëdhënieve mes të Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë.
2. Mjetet financiare nga pika 1. e këtij vendimi ndahen nga Shpenzimet e Paparashikuara, nën programi Shpenzimet e Paparashikuara me kod 13100, kategoria ekonomike e Rezervës dhe transferohen në Prokurorinë e Shtetit në kodin organizativ 250, nën programi Prokurorët dhe Administrata me kod 33500, kategoria ekonomike e mallrave dhe shërbimeve.
3. Obligohet Prokuroria e Shtetit dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 06/88

Datë: 20.05.2016

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Vendimit të Qeverisë së Kosovës nr. 02/86 të datës 29.04.2016 për aprovimin e Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve për vitet 2017-2019, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011, dhe të nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 20 maj 2016, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet kërkesa e Ministrisë së Financave për shpërndarjen e kontigjencës për korrektim të formulës-pjesës së grantit të përgjithshëm për vitin 2017 për komuna në vlerë prej 4,000,000 (katër milionë) euro.
2. Mjetet sipas pikës 1. të këtij vendimi ndahen për 14 komuna të Republikës së Kosovës me popullsi prej më pak se 22,000 (njëzet e dymijë mijë) banorë, për të mundësuar ofrimin e nivelit minimal të shërbimeve për qytetarët e këtyre komunave (shtojca 1).
3. Mjetet sipas pikës 1. të këtij vendimi ndahen sipas komunave në bazë të shtojcës 1. të bashkëngjitur.
4. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që vendimin t'ia procedojë Kuvendit të Republikës së Kosovës për shqyrtim dhe miratim.
5. Obligohet Ministria e Financave dhe komunat e ndikuara për zbatimin e këtij vendimi.
6. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 07/88

Datë: 20.05.2016

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 4 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011, dhe të nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 20 maj 2016, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet në parim Nisma për lidhjen e Marrëveshjes për Ndihmë të Ndërsjellë Juridike në Çështjet Civile dhe Tregtare ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë.
2. Përgjatë negocimit të kësaj Marrëveshjeje, obligohet Ministria e Drejtësisë që të procedoj konform dispozitave të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare dhe dispozitave tjera përkatëse në fuqi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Isa MUSTAFA**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë





**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 08/88

Datë: 20.05.2016

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 6 të Ligjit Nr. 04/L-198 për Tregtinë e Mallërave Strategjike, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011, dhe të nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 20 maj 2016, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet Lista e Mallrave me Përdorim të Dyfishtë, të cilat i nënshtrohen kontrollit shtetëror të importit dhe eksportit.
2. Obligohet Departamenti për Mallra Strategjike në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë dhe Komisioni për Licencimin e Mallrave dhe Shërbimeve Strategjike për zbatimin e këtij vendimi.
3. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është edhe Lista, e cila do të publikohet nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Isa MUSTAFA**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

Nr. 09/88

Datë: 20.05.2016

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të Ligjit Nr. 04/L-144 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, dhe të Rregullores QRK Nr. 23/2013 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimit të Pronës së Paluajtshme të Komunës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011, dhe të nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 20 maj 2016, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet Propozimi i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, lidhur me Kërkesën e Komunës së Pejës për Këmbimin e pronave të paluajtshme për ngastrat kadastrale 1/1 dhe 2/1 ZK-Bellopojë pronë e Ekonomisë së Pyjeve, me ngastrat kadastrale 3/1, 8/1 ZK Kuqishtë, 88/1 ZK Haxhaj, 1/1 ZK Bogë, 99/1, 216/1 ZK Drelaj, 39/1, 281/2 ZK-Shkrel, 8/1, 9, 13/1 dhe 77/1 ZK-Malaj, në pronësi të Komunës së Pejës, për qëllim të realizimit të Projektit "Ndërtimi i Teleferikut në Komunën e Pejës"
2. Ky vendim bashkë me pjesët tabelare dhe grafike të tij paraqet bazë juridike për regjistrim në librat kadastral në emër të titullarëve të rinj, të përshkruar në pikën 1. të këtij vendimi.
3. Obligohet Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Komuna e Pejës dhe institucionet tjera përkatëse për zbatimin e këtij vendimi.
4. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, zyrat kadastrale janë të obliguara të kryejnë veprimet procedurale dhe teknike për zbatimin e tij.
5. Vendimi hyn në fuqi pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 10/88

Datë: 20.05.2016

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011, dhe të nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 20 maj 2016, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Ndahen mjete financiare në vlerë prej 300,000.00 (treqindmijë) euro për Kompaninë Rajonale të Ujësjellësit Mitrovica.
2. Mjetet financiare nga pika 1. e këtij vendimi ndahen nga Rezerva e Qeverisë, nën programi Shpenzimet e paparashikuara me kod 13100, dhe barten në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik me kod organizativ 213, nën programi Uji dhe Hedhurinat me kod 22500 në kategorinë ekonomike të subvencioneve dhe transfereve.
3. Obligohet Ministria e Zhvillimit Ekonomik dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Isa MUSTAFA**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë